



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
Nr. Prot. 01-4339/15
Bil. Prot. Prot No.
Data 20.11.2015
Datum
Date

02
PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.11.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2792/15, për z. Rizah Bajraktari, Anëtar i Kuvendit Komunal në Lipjan, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Rizah Bajraktari, Anëtar i Kuvendit Komunal në Lipjan, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, z. Bajraktari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuara një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast z. Bajraktari është njoftuar për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, z. Bajraktari është deklaruar se brenda afatit ligjor do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve.

Ndërkohë, zyrtari i lartë z. Bajraktari ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/4312/15), në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privat Barnatore “Anida”.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

